Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01/27
Datë: 02.02.2024

Në mbështetje të neneve 8, 9 dhe 16 të Ligjit Nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, të Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) për Kriteret dhe procedurat për verifikimin e standardit të profesionit nr. 28/2014, nenit 5 paragrafi 4, 5 dhe 6 si dhe nenit 6 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 01/196 e punës e Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 26.01.2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

1. **Aprovohen** Standardet e Profesionit sipas rekomandimeve të ekipeve të ekspertëve si Standarde Kombëtare të Profesionit me kohëzgjatje pesë (5) vjeçare, përkatësisht nga data 26.01.2024 deri më 25.01.2029 me këto emërtim dhe kod:

1.1. Kultivuesit e kulturave të përziera dhe rritësit e kafshëve, me kod KPK 6130 dhe me nivelin IV të kualifikimit sipas KKK.

1.2. Salduesit dhe prerësit me flakë, me kod 7212 dhe me nivelin IV të kualifikimit sipas KKK.

1.3. Ciceronët e udhëtimit, me kod 5113 dhe me nivelin V të kualifikimit sipas KKK.

1.4. Operuesit e makinerive të lëvizjes së dheut dhe të ngjashëm, me kod 8342 dhe me nivel IV të kualifikimeve sipas KKK

1.5. Përgatitësit dhe drejtuesit e metalit strukturor, me kod 7214 , me nivel IV të kualifikimeve sipas KKK.

2. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Bazuar në kërkesën e Këshillit për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe për të Rritur, të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (KAAPRr/MASHT) për verifikimin e këtyre standardeve të profesionit. Këshilli Drejtues i AKK-së, në mbledhjen e mbajtur më 26.01.2024 shqyrtoj raportet përfundimtare të ekipeve të ekspertëve nga procesi i verifikim të standardeve të profesionit dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve gjatë realizimit të takimeve dhe vizitave me palët e interesit, si dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna nga ekipet e eksperteve vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë, sipas nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit kompetent, në afat prej 30 ditësh nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ, sipas nenit 127 të LPPA.

Vendimi u dërgohet:

1. KAAPRr.-së;
2. Arkivit të AKK-së.

Dr. Besim Mustafa

Kryetar i KD të AKK